

**KONTRATË OPSIONI PËR SHITJEN E KUOTËS**  
**(CALL AND PUT OPTION AGREEMENT)**

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Bleresi**" ose te dy se bashku referuar si "**Bleresit**")

Nga ana tjetër:

3. **Bledar Gjocaj**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 23.11.1982, lindur në Vlore dhe banues në adresën Rruga Abdyl Frasherit, P. 6/1, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I21123036P (në vijim referohet si "**Shitesi**")

*Duke qenë se*

- A) **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k** është pronar i një kuote që përfaqëson 59.71 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 2,507,914 (dy milion e pesëqind e shtate mije e nentëqind e katërmbedhjetë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.3% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Z. Bledar Gjocaj nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- B) **TAG Engineering sh.p.k** është pronar i një kuote që përfaqëson 40.29 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 1,692,086 (një milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e dy mije e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.2% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Z. Bledar Gjocaj nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").

C) Si rrjedhojë e Kontratës për Shitjen e Kuotës date 15.12.2021, Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 58.51% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë dhe TAG Engineering sh.p.k. do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 39.49% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë ndërsa Bledar Gjoçaj do të fitojë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë ("**Kuota e Shitësit**");

D) Është kusht për hyrjen në fuqi të Kontratës për Shitjen e Kuotës që:

- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Shitësi ka rënë dakord dhe dëshiron që të krijohet në favor të Bleresve e drejta (opsioni) për blerjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Blerësit**"), opsion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Bleresve që të blejnë, dhe ngarkon Shitësin me detyrimin përfundimtar që të shesë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes sipas Nenit 2.1 në këtë Kontratë;

- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Blerësit kanë rënë dakord dhe dëshirojnë që të krijohet në favor të Shitësit e drejta (opsioni) për shitjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Shitësit**"), opsion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Shitësit që të shesë, dhe ngarkon Blerësit me detyrimin përfundimtar që të blejnë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Shitësi të Opsionit të Shitësit sipas Nenit 2.2 në këtë Kontratë (Opsioni i Shitësit së bashku me Opsionin e Blerësit "**Opsionet**").

E) Palët shprehën se janë dakord për marrjen përsipër të së drejtës ose detyrimit, sipas rastit, për të shitur ose për të blerë Kuotën e Shitësit, sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate;

F) Palët dëshirojnë gjithashtu që të rregullojnë marrëdhënien e tyre të ortakërisë gjatë kohëzgjatjes së Opsioneve, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:

## **Neni 1 Përkufizime**

1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.

## **Neni 2 Opsioni i Blerjes dhe Opsioni i Shitjes**

### **2.1 Opsioni i Blerjes**

2.1.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Bleresve, një opsion (e drejtë) ekskluziv i blerjes dhe, detyrimi i shitjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të ("**Opsioni i**

**Blerjes**”), Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.

- 2.1.2 Opsioni i Blerjes mund të ushtrohet nga Blerësit në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh (“**Afati i Opsionit**”) nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Blerjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Blerësve, te cilët mund të vendosin, në gjykimin e tyre të plotë, ta ushtrojnë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojnë ose të paraqesin ndonjë shkak ose arsye. Blerësit mund ta ushtrojnë Opsionin e Blerjes në një ose më shumë herë, mbi të gjithë Kuotën e Shitësit ose vetëm për një pjesë të saj, me kusht që ushtrimi i Opsionit të Blerjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.1.3 Shitësi, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ka dhënë pëlqimin e tij të lirë, përfundimtar dhe të përvokueshëm për shitjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve dhe ka pranuar se, Shitësi nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi të çdo lloj forme mbi Kuotën e Shitësit me palë të treta përpara përfundimit të Afatit të Opsionit.
- 2.1.4 Opsioni i Blerjes, e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin A (“**Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes**”), nëpërmjet të cilit Blerësit njoftojnë Shitësin se po ushtrojnë Opsionin e Blerjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit. Pavarësisht sa më lart, Shitësi ka detyrimin të nënshkruajë çdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve në Datën e Njoftimit.

## 2.2 Opsioni i Shitjes

- 2.2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Shitësit, një opsion (e drejtë) ekskluziv i shitjes dhe, detyrimi i blerjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të (“**Opsioni i Shitjes**”). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.
- 2.2.2 Opsioni i Shitjes mund të ushtrohet nga Shitësi, në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh (“**Afati i Opsionit**”) nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Shitjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Shitësit, i cili mund të vendosë, në gjykimin e tij të plotë, ta ushtrojnë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojë ose të paraqesë ndonjë shkak ose arsye. Shitësi mund ta ushtrojnë Opsionin e Shitësit vetëm mbi të gjithë Kuotën e Shitësit me kusht që ushtrimi i Opsionit të Shitjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.2.3 Blerësit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kanë dhënë pëlqimin e tyre të lirë, përfundimtar dhe të përvokueshëm për blerjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit.
- 2.2.4 Opsioni i Shitjes e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit, prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin B (“**Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes**”), nëpërmjet të cilit

Shitësi njofton Blerësit se po ushtron Opsionin e Shitjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit.

- 2.2.5 Pavarësisht sa më lart, Blerësit kanë detyrimin të nënshkruajnë çdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit në Datën e Njoftimit.

### **2.3 Dispozita të përbashkëta për Opsionin e Shitjes dhe Opsionit të Blerjes**

- 2.3.1 Pa cenuar qëllimin e pikës 2.1.4 dhe 2.2.4 dhe, vetëm për të kënaqur kërkesat që mund të lindin për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pranë regjistratit përkatës tregtar, palët kanë nënshkruar në Datën e Kontratës një kontratë përfundimtare për shitjen e plotë së Kuotës së Shitësit e cila prodhon efekte juridike përkatësisht në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitësit ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerësit, cilido njoftim të jetë i pari. Të gjitha kopjet e kontratës të nënshkruar sipas kësaj pike do të ruhen nga Blerësit, te cilët kanë detyrimin t'i dorëzojnë Shitësit kopjen përkatëse të kontratës në rastet kur secila nga Palët ushtron të drejtën e Opsionit të Shitjes apo Blerjes përkatësisht brenda Afatit të Opsionit.
- 2.3.2 Palët bien dakord që pas përfundimit të Afatit të Opsionit të përcaktuar në pikën 2.1.2 dhe 2.2.2 të kësaj Kontrate dhe nëse e drejta e Opsionit të Blerjes ose Shitjes nuk është ushtruar nga Pala përkatëse, kontrata përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e përmendur në pikën 2.3.1 do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme dhe Palët do t'i shkatërrojnë ato në prani të njëra-tjetrës.

### **Neni 3 Çmimi i Shitjes**

- 3.1 Në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes ose Opsionit të Shitjes përkatësisht nga Blerësit apo nga Shitësi, Blerësit do t'i paguajnë Shitësit për fitimin e pronësisë mbi Kuotën e Shitësit, çmimin total të barabartë me vlerën nominale të Kuotës së Shitësit në Datën e Njoftimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes ose, sipas rastit, Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes. Llogaria bankare e Shitësit në të cilën do të kryhet pagesa e çmimit.
- 3.2 Palët kanë pranuar shprehimisht se pronësia mbi Kuotën e Shitësit, kalon tek Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes, sipas rastit, sipas pikave 2.1.4 ose 2.2.4 të kësaj Kontrate, pavarësisht momentit të pagimit të çmimit nga ana e Blerësve.

### **Neni 4 Taksa, tatimet, shpenzimet**

- 4.1 Cdo taksë, tatim, shpenzim ose tarifa të tjera që duhen paguar si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i blerjes së Kuotës së Shitësit, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj

dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

## Neni 5

### Detyrime shtesë, Deklarata dhe Garanci

#### 5.1 Shitësi deklaron, merr përsipër dhe i garanton Blerësve sa më poshtë vijon:

- (a) Opsioni i Blerjes së Kuotës së Shitësit, sipas kësaj Kontrate është ekskluziv dhe Shitësi nuk do të krijojë në favor të personave të tretë opsione, kufizime apo të drejta të tjera në lidhje me Kuotën e Shitësit;
- (b) Pëlqimi i Shitësit për shitjen e Kuotës së Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (c) Shitësi do të nënshkruajë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohej nga Blerësit me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes;
- (d) Shitësi pranon se Blerësit do të udhëzojë Shoqërinë dhe administratorin e saj që të regjistrojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllimin e njohjes së palëve të treta me kufizimet që rëndojnë mbi Kuotën e Shitësit për shkak të Opsionit të Blerjes dhe në përgjithësi të detyrimeve të tjera të Shitësit sipas kësaj Kontrate;
- (e) Gjatë Afatit të Opsionit, me përjashtim të parashikimeve në këtë Kontratë në favor të Blerësve, Shitësi do të ruajë Kuotën e Shitësit të lirë nga çdo barrë siguruese, peng, garanci pagese, barrë mbi interesat, opion, ose të drejtë parablerje në favor të palëve të treta (secila më poshtë "**Barrë**");
- (f) Kuota e Shitësit që do të transferohet tek Blerësit sipas kësaj Kontrate, do të jetë e lirë nga çdo Barrë dhe e regjistruar rregullisht në emrin e Shitësit;
- (g) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi i çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit është ky Shitës apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin ky Shitës apo Shoqëria është palë, që do të çenonte aftësinë e këtij Shitësi për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (h) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përsheptimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Shitësit.
- (i) Kontratat e shitjes që janë nënshkruar ose që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk çenojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes.

5.2 Blerësit deklarojne, marrin përsipër dhe i garantojne Shitësit sa më poshtë vijon:

- (a) Pëlqimi i Blerësve për blerjen e Kuotës së Shitësit në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga Shitësi është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (b) Blerësit do të nënshkruajnë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Shitësi me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsioneve;
- (c) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Blerësit i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Blerësve, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë keto Blerës, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin Blerësit janë palë, që do të cënonte afësinë e këtij Blerësve për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Blerësve.
- (e) Kontratat e shitjes që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk cënojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit, i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes.

#### Neni 6

##### Dëmshpërblimi

- 6.1 Palët do të dëmshpërblejnë njëra-tjetrën dhe do ta mbajnë të pacenuar palën tjetër për çdo humbje, dëm, detyrim dhe shpenzim (përfshi tarifat dhe shpenzimet ligjore) (së bashku "Dëmi") nëse Dëmi të tilla janë përballuar nga pala përkatëse dhe rrjedhin apo janë të lidhura me pasaktësi, mospërmbushje apo shkelje të detyrimeve, deklaratave dhe garancive të palës tjetër sipas kësaj Kontrate.

#### Neni 7

##### Zgjidhja

- 7.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me miratimin me shkrim të Palëve dhe në rastet e tjera të parashikuara në të.

#### Neni 8

##### Të ndryshme

- 8.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve, dhe në rast të kundërt gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

- 8.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve. Të drejtat, privilegjet, apo detyrimet e përcaktuara, që kanë lindur apo janë krijuar nga kjo Kontratë, nuk mund të transferohen pa miratimin paraprak me shkrim të çdo Palë.
- 8.3 Palët bien dakord dhe duhet të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për regjistrimin e kësaj Kontrate në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim informimin e palëve të treta.
- 8.4 Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim të të dyja palëve.
- 8.5 Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera të kërkuara apo të lejuara, që duhet t'ju jepen palëve në Kontratë duhet të bëhen me shkrim si dhe të dërgohen me faks apo postohen me postë të regjistruar, apo të dorëzohen me Korrier, në adresën e palës, ashtu siç përcaktohet më poshtë, ose në çdo adresë tjetër të vlefshme që palët i kanë bërë të ditur njëra-tjetrës me shkrim në përputhje me këtë pikë 9.4. Dorëzimi i njoftimeve në emër të secilës palë në adresat e mëposhtme përbën njoftim të vlefshëm sipas kësaj Kontrate, pavarësisht faktit që kjo palë mund të ketë ndryshuar adresë, për aq sa ky ndryshim nuk i është njoftuar vlefshmërisht me shkrim palës tjetër.

- Për Shitësin njoftimi do të bëhet në adresën :  
*Rruga Abdyl Frasheri, P. 6/1, Tirane.*
- Për Blerësit njoftimi do të bëhet në adresën:  
Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k: *Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri*  
TAG Engineering sh.p.k: *Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë*

Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë secila.

#### BLERËSIT

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k

Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.

Armand Shara  
Administrator i Përgjithshem



#### SHITËSI

Bledar Gjocaj

*Bledar Gjocaj*  
*[Signature]*

*Armande Gjocaj*  
*[Signature]*



## ANEKSI A

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Blerjes

[Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Blerjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")  
**Në vëmendje të:** [Shitësi]  
[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Blerjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Shitësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Blerjes] në cilësinë e [Blerësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës ekskluzive në favor të Blerësit për të blerë të gjithë kuotën tuaj në kapitalin e shoqërisë ikubINFO SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Cmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe do të paguhet sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]



## ANEKSI B

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Shitjes

[Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Shitjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")

**Në vëmendje të:** [Blerësi]

[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Shitjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Blerësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Shitjes] në cilësinë e [Shitësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës së Shitësit për të shitur të gjithë kuotën në pronësi të Shitësit në kapitalin e shoqërisë IKUBINFO SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Çmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe duhet paguar sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Blerësi/t**")

Nga ana tjetër:

3. **Bledar Gjocaj**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 23.11.1982, lindur në Vlore dhe banues në adresën Rruga Abdyl Frasheri, P. 6/1, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I21123036P (në vijim referuar si "**Shitësi**")

*Duke qenë se*

- A) Shitësi është pronar i një kuote që përfaqëson 0.5 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar („Kuota“) të shoqërisë ikubINFO SHPK regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T ("**Shoqëria**");
- B) Shitësi dhe Blerësit kanë nënshkruar midis tyre në datë **15.12.2021** Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotës („**Kontrata e Opsionit**“) nëpërmjet të cilës Shitësi ka krijuar në favor të Blerësit një opSION ekskluziv për blerjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit dhe Blerësi ka krijuar në favor të Shitësit një opSION ekskluziv për shitjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit;
- C) Në Kontratën e Opsionit, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë nëpërmjet të cilës Shitësi në mënyrë përfundimtare pranon paraprakisht shitjen e Kuotës së tij në Shoqëri në Datën e Njoftimit e Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit të termit në Kontratën e Opsionit) si një formalitet ky që mund të lindë i nevojshëm për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi Kuotën nga Shitësi tek Blerësi pranë regjistrimit tregtar;

Atëherë, palët në këtë kontratë ("Kontrata") bien dakord si më poshtë:

### **Neni 1 Përkufizime**

- 1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.
- 1.2 Të gjitha përcaktimet dhe përkufizimet e termave me gërma kapitale në Kontratën e Opsionit kanë të njëjtin kuptim në këtë Kontratë përveç rastit kur konteksti parashtron një kuptim të ndryshëm.

### **Neni 2 Objekti i Kontratës**

- 2.1 Objekt i kësaj Kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit tek Blerësi, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit në Kontratën e Opsionit), bashkë me të gjitha të drejtat e lidhura me këtë Kuotë.
- 2.2 Me kalimin e pronësisë së Kuotës në pronësi të Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes, Shitësi humbet cdo cilësi të ortakut në Shoqëri.

### **Neni 3 Çmimi i Kuotës dhe Mënyra e Pagesës**

- 3.1 Çmimi i Kuotës që përfaqëson tërësinë e pjesëmarrjes së Shitësit në Shoqëri është i barabartë me vlerën nominale të Kuotës në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes.
- 3.2 Blerësi do të paguajë çmimin brenda 30 ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes në llogarinë bankare të Shitësit të përcaktuar në Kontratën e Opsionit.

### **Neni 4 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas nenit 2.
- 4.2 Shitësi është një person juridik i organizuar dhe që operon sipas ligjeve shqiptare.
- 4.3 Shitësi ka të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.4 Pronësia e Kuotës:
  - (a) Shitësi është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues i Kuotës;

- (b) Kuota dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to (është e lirë nga çdo lloj pengu apo barrë, e çfarëdo natyre qoftë, dhe Shitësi ka të drejta dhe fuqi të plotë për të shitur, kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën tek Blerësi, sipas dispozitave të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Opsionit.

4.5 Kuota përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar dhe paguar të Shoqërisë.

4.6 Shitësi nuk është në gjendje falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure likuidimi në çfarëdo juridiksioni dhe nuk ka propozuar asnjë Kontrate apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh.

## Neni 5

### Kostot

- 5.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjërishit ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës.
- 5.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt palë i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

## Neni 6

### Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 6.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.
- 6.2 Cdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përse i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

## Neni 7

### Të Ndryshme

- 7.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të palëve.
- 7.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve.
- 7.3 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontrate dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontrates

7.4 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe (njëra për Shitësin, një për Blerësin dhe një kopje për tu depozituar në regjistrin tregtar) secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.

**BLERESIT**

**Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k**

**Migena Sherko**  
**Administratore e Përgjithshme**

**TAG Engineering sh.p.k.**

**Armand Shara**  
**Administrator i Përgjithshëm**



**SHITESI**

**Bledar Gjocaj**

*Bledar Gjocaj*  
*[Handwritten signature]*

*Ernelinde Gjocaj*  
*[Handwritten signature]*

**KONTRATË OPSIONI PËR SHITJEN E KUOTËS**  
**(CALL AND PUT OPTION AGREEMENT)**

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Bleresi**" ose te dy se bashku referuar si "**Bleresit**")

Nga ana tjetër:

3. **Bora Petre**, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e datëlindjes 30.10.1982, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. Ali Demi, pallatet Vind, pallati 92, Hyrja 3, Ap 1, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I26030095W (në vijim referohet si "**Shitesit**")

*Duke qenë se*

- A) **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 59.71 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasheri", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tiranë, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 2,507,914 (dy milion e peseqind e shtate mijë e nenteqind e katërmëdhjete) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.3% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Bleresit nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- B) **TAG Engineering sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 40.29 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasheri", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tiranë, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 1,692,086 (një milion e gjashtëqind e nentëdhjete e dy mijë e tetëdhjete e gjashtë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.2% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Bleresit nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").



- C) Si rrjedhojë e Kontratës për Shitjen e Kuotës date 15.12.2021, Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 58.51% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë dhe TAG Engineering sh.p.k. do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 39.49% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë ndërsa Bora Petre do të fitojë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë (“**Kuota e Shitësit**”);
- D) Është kusht për hyrjen në fuqi të Kontratës për Shitjen e Kuotës që:
- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Shitësi ka rënë dakord dhe dëshiron që të krijohet në favor të Bleresve e drejta (opsioni) për blerjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate (“**Opsioni i Blerësit**”), opion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Bleresve që të blejnë, dhe ngarkon Shitësin me detyrimin përfundimtar që të shesë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes sipas Nenit 2.1 në këtë Kontratë;
  - palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Blerësit kane rënë dakord dhe dëshirojnë që të krijohet në favor të Shitësit e drejta (opsioni) për shitjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate (“**Opsioni i Shitësit**”), opion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Shitësit që të shesë, dhe ngarkon Blerësit me detyrimin përfundimtar që të blejnë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Shitësi të Opsionit të Shitësit sipas Nenit 2.2 në këtë Kontratë (Opsioni i Shitësit së bashku me Opsionin e Blerësit “**Opsionet**”).
- E) Palët shprehen se janë dakord për marrjen përsipër të së drejtës ose detyrimit, sipas rastit, për të shitur ose për të blerë Kuotën e Shitësit, sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate;
- F) Palët dëshirojnë gjithashtu që të rregullojnë marrëdhënien e tyre të ortakërisë gjatë kohëzgjatjes së Opsioneve, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Atëherë, palët në këtë kontratë (“**Kontrata**”) bien dakord si më poshtë:

## Neni 1 Përkufizime

- 1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.

## Neni 2 Opsioni i Blerjes dhe Opsioni i Shitjes

### 2.1 Opsioni i Blerjes

- 2.1.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Bleresve, një opion (e drejtë) ekskluziv i blerjes dhe, detyrimi i shitjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të (“**Opsioni i**

**Blerjes**). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.

- 2.1.2 Opsioni i Blerjes mund të ushtrohet nga Blerësit në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh ("**Afati i Opsionit**") nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Blerjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Blerësve, te cilet mund të vendosin, në gjykimin e tyre të plotë, ta ushtrojë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojnë ose të paraqesin ndonjë shkak ose arsye. Blerësit mund ta ushtrojnë Opsionin e Blerjes në një ose më shumë herë, mbi të gjithë Kuotën e Shitësit ose vetëm për një pjesë të saj, me kusht që ushtrimi i Opsionit të Blerjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.1.3 Shitësi, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ka dhënë pëlqimin e tij të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për shitjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve dhe ka pranuar se, Shitësi nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi të cdo lloj forme mbi Kuotën e Shitësit me palë të treta përpara përfundimit të Afatit të Opsionit.
- 2.1.4 Opsioni i Blerjes, e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin A ("**Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes**"), nëpërmjet të cilit Blerësit njoftojnë Shitësin se po ushtrojnë Opsionin e Blerjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit. Pavarësisht sa më lart, Shitësi ka detyrimin të nënshkruajë cdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve në Datën e Njoftimit.

## 2.2 Opsioni i Shitjes

- 2.2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Shitësit, një opsion (e drejtë) ekskluziv i shitjes dhe, detyrimi i blerjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të ("**Opsioni i Shitjes**"). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.
- 2.2.2 Opsioni i Shitjes mund të ushtrohet nga Shitësi, në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh ("**Afati i Opsionit**") nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Shitjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Shitësit, i cili mund të vendosë, në gjykimin e tij të plotë, ta ushtrojë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojë ose të paraqesë ndonjë shkak ose arsye. Shitësi mund ta ushtrojë Opsionin e Shitësit vetëm mbi të gjithë Kuotën e Shitësit me kusht që ushtrimi i Opsionit të Shitjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.2.3 Blerësit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kanë dhënë pëlqimin e tyre të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për blerjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit.
- 2.2.4 Opsioni i Shitjes e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit, prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin B ("**Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes**"), nëpërmjet të cilit



Shitësi njofton Blerësit se po ushtron Opsionin e Shitjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit.

- 2.2.5 Pavarësisht sa më lart, Blerësit kanë detyrimin të nënshkruajnë çdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit në Datën e Njoftimit.

### **2.3 Dispozita të përbashkëta për Opsionin e Shitjes dhe Opsionit të Blerjes**

- 2.3.1 Pa cenuar qëllimin e pikës 2.1.4 dhe 2.2.4 dhe, votëm për të kënaqur kërkesat që mund të lindin për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pranë regjistrimit përkatës tregtar, palët kanë nënshkruar në Datën e Kontratës një kontratë përfundimtare për shitjen e plotë së Kuotës së Shitësit e cila prodhon efekte juridike përkatësisht në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitësit ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerësit, cilido njoftim të jetë i pari. Të gjitha kopjet e kontratës të nënshkruar sipas kësaj pike do të ruhen nga Blerësit, të cilët kanë detyrimin t'i dorëzojnë Shitësit kopjen përkatëse të kontratës në rastet kur secila nga Palët ushtron të drejtën e Opsionit të Shitjes apo Blerjes përkatësisht brenda Afatit të Opsionit.
- 2.3.2 Palët bien dakord që pas përfundimit të Afatit të Opsionit të përcaktuar në pikën 2.1.2 dhe 2.2.2 të kësaj Kontrate dhe nëse e drejta e Opsionit të Blerjes ose Shitjes nuk është ushtruar nga Pala përkatëse, kontrata përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e përmendur në pikën 2.3.1 do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme dhe Palët do t'i shkatërrojnë ato në prani të njëra-tjetrës.

### **Neni 3**

#### **Çmimi i Shitjes**

- 3.1 Në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes ose Opsionit të Shitjes përkatësisht nga Blerësit apo nga Shitësi, Blerësit do t'i paguajnë Shitësit për fitimin e pronësisë mbi Kuotën e Shitësit, çmimin total të barabartë me vlerën nominale të Kuotës së Shitësit në Datën e Njoftimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes ose, sipas rastit, Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes. Llogaria bankare e Shitësit në të cilën do të kryhet pagesa e çmimit.
- 3.2 Palët kanë pranuar shprehimisht se pronësia mbi Kuotën e Shitësit, kalon tek Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes, sipas rastit, sipas pikave 2.1.4 ose 2.2.4 të kësaj Kontrate, pavarësisht momentit të pagimit të çmimit nga ana e Blerësit.

### **Neni 4**

#### **Taksa, tatimet, shpenzimet**

- 4.1 Cdo taksë, tatim, shpenzim ose tarifa të tjera që duhen paguar si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i blerjes së Kuotës së Shitësit, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj

dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kuji pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

## Neni 5

### Detyrime shtesë, Deklarata dhe Garanci

#### 5.1 Shitësi deklaron, merr përsipër dhe i garanton Blerësve sa më poshtë vijon:

- (a) Opsioni i Blerjes së Kuotës së Shitësit, sipas kësaj Kontrate është ekskluziv dhe Shitësi nuk do të krijojë në favor të personave të tretë opsione, kufizime apo të drejta të tjera në lidhje me Kuotën e Shitësit;
- (b) Pëlqimi i Shitësit për shitjen e Kuotës së Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (c) Shitësi do të nënshkruajë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Blerësit me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes;
- (d) Shitësi pranon se Blerësit do të udhëzojë Shoqërinë dhe administratorin e saj që të regjistrojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllimin e njohjes së palëve të treta me kufizimet që rëndojnë mbi Kuotën e Shitësit për shkak të Opsionit të Blerjes dhe në përgjithësi të detyrimeve të tjera të Shitësit sipas kësaj Kontrate;
- (e) Gjatë Afatit të Opsionit, me përjashtim të parashikimeve në këtë Kontratë në favor të Blerësve, Shitësi do të ruajë Kuotën e Shitësit të lirë nga çdo barrë siguroese, peng, garanci pagese, barrë mbi interesat, opion, ose të drejtë parablerje në favor të palëve të treta (secila më poshtë "Barrë");
- (f) Kuota e Shitësit që do të transferohet tek Blerësit sipas kësaj Kontrate, do të jetë e lirë nga çdo Barrë dhe e regjistruar rregullisht në emrin e Shitësit;
- (g) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit është ky Shitës apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin ky Shitës apo Shoqëria është palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Shitësi për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (h) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Shitësit.
- (i) Kontratat e shitjes që janë nënshkruar ose që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk cënojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes.

5.2 Blerësit deklarojnë, marrin përsipër dhe i garantojnë Shitësit sa më poshtë vijon:

- (a) Pëlqimi i Blerësve për blerjen e Kuotës së Shitësit në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga Shitësi është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (b) Blerësit do të nënshkruajnë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Shitësi me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsioneve;
- (c) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Blerësit i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Blerësve, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë keto Blerës, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi ne te cilin Blerësit janë palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Blerësve për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimin të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Blerësve.
- (e) Kontratat e shitjes që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk çenojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit, i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes.

#### Neni 6

##### Dëmshpërblimi

- 6.1 Palët do të dëmshpërblejnë njëra-tjetrën dhe do ta mbajnë të pacenuar palën tjetër për çdo humbje, dëm, detyrim dhe shpenzim (përfshi tarifën dhe shpenzimet ligjore) (së bashku "Dëmi") nëse Dëmi të tilla janë përballuar nga pala përkatëse dhe rrjedhin apo janë të lidhura me pasaktësi, mospërmbushje apo shkelje të detyrimeve, deklaratave dhe garancive të palës tjetër sipas kësaj Kontrate.

#### Neni 7

##### Zgjidhja

- 7.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me miratimin me shkrim të Palëve dhe në rastet e tjera të parashikuara në të.

#### Neni 8

##### Të ndryshme

- 8.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve, dhe në rast të kundërt gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

- 8.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve. Të drejtat, privilegjet, apo detyrimet e përcaktuara, që kanë lindur apo janë krijuar nga kjo Kontratë, nuk mund të transferohen pa miratimin paraprak me shkrim të çdo Pale.
- 8.3 Palët bien dakord dhe duhet të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për regjistrimin e kësaj Kontrate në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim informimin e palëve të treta.
- 8.4 Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim të të dyja palëve.
- 8.5 Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera të kërkuara apo të lejuara, që duhet t'ju jepen palëve në Kontratë duhet të bëhen me shkrim si dhe të dërgohen me faks apo postohen me postë të regjistruar, apo të dorëzohen me Korrier, në adresën e palës, ashtu siç përcaktohet më poshtë, ose në çdo adresë tjetër të vlefshme që palët i kanë bërë të ditur njëra-tjetrës me shkrim në përputhje me këtë pikë 9.4. Dorëzimi i njoftimeve në emër të secilës palë në adresat e mëposhtme përbën njoftim të vlefshëm sipas kësaj Kontrate, pavarësisht faktit që kjo palë mund të ketë ndryshuar adresë, për aq sa ky ndryshim nuk i është njoftuar vlefshmërisht me shkrim palës tjetër.

- Për Shitësin njoftimi do të bëhet në adresën :

*Rr. Ali Demi, pallatet Vind, pallati 92, Hyrja 3, Ap 1*

- Për Blerësit njoftimi do të bëhet në adresën:

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k: *Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri*

TAG Engineering sh.p.k: *Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë*

Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë secila.

**BLERËSIT**

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k

Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.

Armand Shara

Administrator i Përgjithshem



**SHITËSI**

Bora Petre



*Bora Petre*  
*Armand Shara*  
*Bora Petre*

## ANEKSI A

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Blerjes

[Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Blerjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")  
**Në vëmendje të:** [Shitësi]  
[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Blerjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Shitësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Blerjes] në cilësinë e [Blerësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës ekskluzive në favor të Blerësit për të blerë të gjithë kuotën tuaj në kapitalin e shoqërisë ikubInfo SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Cmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe do të paguhet sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]

## ANEKSI B

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Shitjes [Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Shitjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")  
**Në vëmendje të:** [Blerësi]  
[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Shitjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Blerësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Shitjes] në cilësinë e [Shitësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës së Shitësit për të shitur të gjithë kuotën në pronësi të Shitësit në kapitalin e shoqërisë ikubInfo SHPK, me vlerë totale nominale prej [\_\_\_] Lekesh.

Çmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe duhet paguar sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]



## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, EGI Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "Blerësi/t")

Nga ana tjetër:

3. **Bora Petre**, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e datëlindjes 30.10.1982, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. Ali Demi, pallatet Vind, pallati 92, Hyrja 3, Ap 1, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I26030095W (në vijim referuar si "Shitësi")

Duke qenë se

- A) Shitësi është pronar i një kuote që përfaqëson 0.5 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar („Kuota“) të shoqërisë ikubINFO SHPK regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T („Shoqëria“);
- B) Shitësi dhe Blerësit kanë nënshkruar midis tyre në datë **15.12.2021** Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotës („Kontrata e Opsionit“) nëpërmjet të cilës Shitësi ka krijuar në favor të Blerësit një opion ekskluziv për blerjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit dhe Blerësi ka krijuar në favor të Shitësit një opion ekskluziv për shitjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit;
- C) Në Kontratën e Opsionit, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë nëpërmjet të cilës Shitësi në mënyrë përfundimtare pranon paraprakisht shitjen e Kuotës së tij në Shoqëri në Datën e Njoftimit e Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit të termit në Kontratën e

Opsionit) si një formalitet ky që mund të lindë i nevojshëm për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi Kuotën nga Shitësi tek Blerësi pranë regjistrit tregtar;

Atëherë, palët në këtë kontratë ("Kontrata") bien dakord si më poshtë:

### **Neni 1 Përkufizime**

- 1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.
- 1.2 Të gjitha përcaktimet dhe përkufizimet e termave me gërma kapitale në Kontratën e Opsionit kanë të njëjtin kuptim në këtë Kontratë përveç rastit kur konteksti parashtron një kuptim të ndryshëm.

### **Neni 2 Objekti i Kontratës**

- 2.1 Objekt i kësaj Kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit tek Blerësi, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit në Kontratën e Opsionit), bashkë me të gjitha të drejtat e lidhura me këtë Kuotë.
- 2.2 Me kalimin e pronësisë së Kuotës në pronësi të Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes, Shitësi humbet çdo cilësi të ortakut në Shoqëri.

### **Neni 3 Çmimi i Kuotës dhe Mënyra e Pagesës**

- 3.1 Çmimi i Kuotës që përfaqëson tërësinë e pjesëmarrjes së Shitësit në Shoqëri është i barabartë me vlerën nominale të Kuotës në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes.
- 3.2 Blerësi do të paguajë çmimin brenda 30 ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes në llogarinë bankare të Shitësit të përcaktuar në Kontratën e Opsionit.

### **Neni 4 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas nenit 2.
- 4.2 Shitësi është një person juridik i organizuar dhe që operon sipas ligjeve shqiptare.
- 4.3 Shitësi ka të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.





#### 4.4 Pronësia e Kuotës:

- (a) Shitësi është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues i Kuotës;
- (b) Kuota dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to (është e lirë nga cdo lloj pengu apo barre, e çfarëdo natyre qoftë, dhe Shitësi ka të drejta dhe fuqi të plotë për të shitur, kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën tek Blerësi, sipas dispozitave të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Opsionit.

4.5 Kuota përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar dhe paguar të Shoqërisë.

4.6 Shitësi nuk është në gjendje falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure likuidimi në çfarëdo juridiksioni dhe nuk ka propozuar asnjë Kontrate apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh.

### Neni 5

#### Kostot

- 5.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjorë ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës.
- 5.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

### Neni 6

#### Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 6.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.
- 6.2 Cdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përta i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

### Neni 7

#### Të Ndryshme

- 7.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të palëve.
- 7.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtarëve të palëve.



7.3 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontrate dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontrates

7.4 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe (njëra për Shitësin, një për Blerësin dhe një kopje për tu depozituar në regjistrin tregtar) secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontrate.

**BLERESIT**

**Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k.**

**Migena Sherko**  
**Administratore e Përgjithshme**

**TAG Engineering sh.p.k.**

**Armand Shara**  
**Administrator i Përgjithshëm**



**SHITESI**

**Bora Petre**



*Bora Petre*  
*Armand Shara*

**KONTRATË OPSIONI PËR SHITJEN E KUOTËS**  
**(CALL AND PUT OPTION AGREEMENT)**

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Bleresi**" ose te dy se bashku referuar si "**Bleresit**")

Nga ana tjetër:

3. **Ermond Parllaku**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 30.08.1982, lindur në Krume, Kukes dhe banues në adresën Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I20830060T (në vijim referohet si "**Shitesi**")

Duke qenë se

- A) **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 59.71 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 2,507,914 (dy milion e pesëqind e shtatë mijë e nentëqind e katërmbedhjetë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.3% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Z.Ermond Parllaku nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- B) **TAG Engineering sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 40.29 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 1,692,086 (një milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.2% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Z.Ermond Parllaku nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- C) Si rrjedhojë e Kontratës për Shitjen e Kuotës date 15.12.2021, Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 58.51% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë dhe TAG Engineering sh.p.k. do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 39.49% të kapitalit të

paguar e regjistruar të Shoqërisë ndërsa Ermond Parllaku do të fitojë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë ("**Kuota e Shitësit**");

**D) Është kusht për hyrjen në fuqi të Kontratës për Shitjen e Kuotës që:**

- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Shitësi ka rënë dakord dhe dëshiron që të krijohet në favor të Bleresve e drejta (opsioni) për blerjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Blerësit**"), opsin ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Bleresve që të blejnë, dhe ngarkon Shitësin me detyrimin përfundimtar që të shesë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes sipas Nenit 2.1 në këtë Kontratë;
- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Blerësit kanë rënë dakord dhe dëshirojnë që të krijohet në favor të Shitësit e drejta (opsioni) për shitjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Shitësit**"), opsin ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Shitësit që të shesë, dhe ngarkon Blerësit me detyrimin përfundimtar që të blejnë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Shitësi të Opsionit të Shitësit sipas Nenit 2.2 në këtë Kontratë (Opsioni i Shitësit së bashku me Opsionin e Blerësit "**Opsionet**").

**E) Palët shprehen se janë dakord për marrjen përsipër të së drejtës ose detyrimit, sipas rastit, për të shitur ose për të blerë Kuotën e Shitësit, sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate;**

**F) Palët dëshirojnë gjithashtu që të rregullojnë marrëdhënien e tyre të ortakërisë gjatë kohëzgjatjes së Opsioneve, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë.**

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:

## **Neni 1**

### **Përkufizime**

**1.1** Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.

## **Neni 2**

### **Opsioni i Blerjes dhe Opsioni i Shitjes**

#### **2.1 Opsioni i Blerjes**

2.1.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Bleresve, një opsin (e drejtë) ekskluziv i blerjes dhe, detyrimi i shitjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të ("**Opsioni i Blerjes**"). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.

2.1.2 Opsioni i Blerjes mund të ushtrohet nga Blerësit në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh ("**Afati i Opsionit**") nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Blerjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Bleresve, te cilet mund të vendosin, në gjykimin e tyre të plotë, ta ushtrojnë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojnë ose të paraqesin ndonjë shkak ose arsye. Blerësit mund ta

ushtrojnë Opsionin e Blerjes në një ose më shumë herë, mbi të gjithë Kuotën e Shitësit ose vetëm për një pjesë të saj, me kusht që ushtrimi i Opsionit të Blerjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.

- 2.1.3 Shitësi, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ka dhënë pëlqimin e tij të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për shitjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Bleresve dhe ka pranuar se, Shitësi nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi të cdo lloj forme mbi Kuotën e Shitësit me palë të treta përpara përfundimit të Afatit të Opsionit.
- 2.1.4 Opsioni i Blerjes, e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin A (“Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes”), nëpërmjet të cilit Blerësit njoftojnë Shitësin se po ushtrojnë Opsionin e Blerjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit. Pavarësisht sa më lart, Shitësi ka detyrimin të nënshkruajë cdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve në Datën e Njoftimit.

## 2.2 Opsioni i Shitjes

- 2.2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Shitësit, një opsion (e drejtë) ekskluziv i shitjes dhe, detyrimi i blerjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të (“Opsioni i Shitjes”). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.
- 2.2.2 Opsioni i Shitjes mund të ushtrohet nga Shitësi, në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh (“Afati i Opsionit”) nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Shitjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Shitësit, i cili mund të vendosë, në gjykimin e tij të plotë, ta ushtrojë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojë ose të paraqesë ndonjë shkak ose arsye. Shitësi mund ta ushtrojë Opsionin e Shitësit vetëm mbi të gjithë Kuotën e Shitësit me kusht që ushtrimi i Opsionit të Shitjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.2.3 Blerësit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kane dhënë pëlqimin e tyre të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për blerjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit.
- 2.2.4 Opsioni i Shitjes e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit, prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin B (“Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes”), nëpërmjet të cilit Shitësi njofton Blerësit se po ushtron Opsionin e Shitjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit.
- 2.2.5 Pavarësisht sa më lart, Blerësit kane detyrimin të nënshkruajnë cdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit në Datën e Njoftimit.

## 2.3 Dispozita të përbashkëta për Opsionin e Shitjes dhe Opsionit të Blerjes

- 2.3.1 Pa cenuar qëllimin e pikës 2.1.4 dhe 2.2.4 dhe, vetëm për të kënaqur kërkesat që mund të lindin për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pranë regjistratit përkatës tregtar, palët kanë nënshkruar në Datën e Kontratës një kontratë përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e cila prodhon efekte juridike përkatësisht në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitësit ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerësit, cilido njoftim të jetë i pari. Të gjitha kopjet e kontratës të nënshkruar sipas kësaj pike do të ruhen nga Blerësit, të cilët kanë detyrimin t'i dorëzojnë Shitësit kopjen përkatëse të kontratës në rastet kur secila nga Palët ushtron të drejtën e Opsionit të Shitjes apo Blerjes përkatësisht brenda Afatit të Opsionit.
- 2.3.2 Palët bien dakord që pas përfundimit të Afatit të Opsionit të përcaktuar në pikën 2.1.2 dhe 2.2.2 të kësaj Kontrate dhe nëse e drejta e Opsionit të Blerjes ose Shitjes nuk është ushtruar nga Pala përkatëse, kontrata përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e përmendur në pikën 2.3.1 do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme dhe Palët do t'i shkatërrojnë ato në prani të njëra-tjetrës.

### **Neni 3**

#### **Çmimi i Shitjes**

- 3.1 Në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes ose Opsionit të Shitjes përkatësisht nga Blerësit apo nga Shitësi, Blerësit do t'i paguajnë Shitësit për fitimin e pronësisë mbi Kuotën e Shitësit, çmimin total të barabartë me vlerën nominale të Kuotës së Shitësit në Datën e Njoftimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes ose, sipas rastit, Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes. Logjaria bankare e Shitësit në të cilën do të kryhet pagesa e çmimit.
- 3.2 Palët kanë pranuar shprehimisht se pronësia mbi Kuotën e Shitësit, kalon tek Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes, sipas rastit, sipas pikave 2.1.4 ose 2.2.4 të kësaj Kontrate, pavarësisht momentit të pagimit të çmimit nga ana e Blerësve.

### **Neni 4**

#### **Taksa, tatimet, shpenzimet**

- 4.1 Cdo taksë, tatim, shpenzim ose tarifa të tjera që duhen paguar si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i blerjes së Kuotës së Shitësit, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

### **Neni 5**

#### **Detyrime shtesë, Deklarata dhe Garanci**

- 5.1 Shitësi deklaron, merr përsipër dhe i garanton Blerësve sa më poshtë vijon:
- (a) Opsioni i Blerjes së Kuotës së Shitësit, sipas kësaj Kontrate është ekskluziv dhe Shitësi nuk do të krijojë në favor të personave të tretë opsione, kufizime apo të drejta të tjera në lidhje me Kuotën e Shitësit;
  - (b) Pëlqimi i Shitësit për shitjen e Kuotës së Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
  - (c) Shitësi do të nënshkruajë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Blerësit me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes;

- (d) Shitësi pranon se Blerësit do të udhëzojë Shoqërinë dhe administratorin e saj që të regjistrojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllimin e njohjes së palëve të treta me kufizimet që rëndojnë mbi Kuotën e Shitësit për shkak të Opsionit të Blerjes dhe në përgjithësi të detyrimeve të tjera të Shitësit sipas kësaj Kontrate;
- (e) Gjatë Afatit të Opsionit, me përjashtim të parashikimeve në këtë Kontratë në favor të Blerësve, Shitësi do të ruajë Kuotën e Shitësit të lirë nga çdo barrë siguruese, peng, garanci pagese, barrë mbi interesat, opsjon, ose të drejtë parablerje në favor të palëve të treta (secila më poshtë "**Barrë**");
- (f) Kuota e Shitësit që do të transferohet tek Blerësit sipas kësaj Kontrate, do të jetë e lirë nga çdo Barrë dhe e regjistruar rregullisht në emrin e Shitësit;
- (g) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit është ky Shitës apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi ne te cilin ky Shitës apo Shoqëria është palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Shitësi për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (h) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përsheptimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Shitësit.
- (i) Kontratat e shitjes që janë nënshkruar ose që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk çenojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes.

## 5.2 Blerësit deklarojne, marrin përsipër dhe i garantojne Shitësit sa më poshtë vijon:

- (a) Pëlqimi i Blerësve për blerjen e Kuotës së Shitësit në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga Shitësi është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (b) Blerësit do të nënshkruajnë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Shitësi me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsioneve;
- (c) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Blerësit i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Blerësve, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë keto Blerës, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi ne te cilin Blerësit janë palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Blerësve për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përsheptimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Blerësve.
- (e) Kontratat e shitjes që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të

ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk çënojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit, i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes.

#### **Neni 6**

##### **Dëmshpërblimi**

- 6.1 Palët do të dëmshpërblejnë njëra-tjetrën dhe do ta mbajnë të pacenuar palën tjetër për çdo humbje, dëm, detyrim dhe shpenzim (përfshi tarifën dhe shpenzimet ligjore) (së bashku "Dëmi") nëse Dëmi të tilla janë përballuar nga pala përkatëse dhe rrjedhin apo janë të lidhura me pasaktësi, mospërbushje apo shkelje të detyrimeve, deklaratave dhe garancive të palës tjetër sipas kësaj Kontrate.

#### **Neni 7**

##### **Zgjidhja**

- 7.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me miratimin me shkrim të Palëve dhe në rastet e tjera të parashikuara në të.

#### **Neni 8**

##### **Të ndryshme**

- 8.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve, dhe në rast të kundërt gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
- 8.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve. Të drejtat, privilegjet, apo detyrimet e përcaktuara, që kanë lindur apo janë krijuar nga kjo Kontratë, nuk mund të transferohen pa miratimin paraprak me shkrim të çdo Pale.
- 8.3 Palët bien dakord dhe duhet të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për regjistrimin e kësaj Kontrate në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim informimin e palëve të treta.
- 8.4 Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim të të dyja palëve.
- 8.5 Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera të kërkuara apo të lejuara, që duhet t'ju jepen palëve në Kontratë duhet të bëhen me shkrim si dhe të dërgohen me faks apo postohen me postë të regjistruar, apo të dorëzohen me Korrier, në adresën e palës, ashtu siç përcaktohet më poshtë, ose në çdo adresë tjetër të vlefshme që palët i kanë bërë të ditur njëra-tjetrës me shkrim në përputhje me këtë pikë 9.4. Dorëzimi i njoftimeve në emër të secilës palë në adresat e mëposhtme përbën njoftim të vlefshëm sipas kësaj Kontrate, pavarësisht faktit që kjo palë mund të ketë ndryshuar adresë, për aq sa ky ndryshim nuk i është njoftuar vlefshmërisht me shkrim palës tjetër.

- Për Shitësin njoftimi do të bëhet në adresën :

*Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë*

- Për Blerësit njoftimi do të bëhet në adresën:

*Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k: Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri*

*TAG Engineering sh.p.k: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë*



Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë secila.

**BLERËSIT**

**SHITËSI**

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k

Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.

Armand Shara  
Administrator i Përgjithshem



Ermond Parllaku

*Ermond Parllaku*

*Ermond Parllaku*

*Armand Shara*

A light blue rectangular stamp with the letters "TAG" in large, bold, white font. Below "TAG" is the text "TAG Engineering sh.p.k." in a smaller font.

## ANEKSLA

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Blerjes

[Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Blerjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")  
**Në vëmendje të:** [Shitësi]  
[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Blerjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Shitësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Blerjes] në cilësinë e [Blerësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës ekskluzive në favor të Blerësit për të blerë të gjithë kuotën tuaj në kapitalin e shoqërisë IkubInfo SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Çmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe do të paguhet sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]

## ANEKSI B

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Shitjes [Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Shitjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")

**Në vëmendje të:** [Blerësi]

[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Shitjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Blerësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Shitjes] në cilësinë e [Shitësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës së Shitësit për të shitur të gjithë kuotën në pronësi të Shitësit në kapitalin e shoqërisë ikubINFO SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Cmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe duhet paguar sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

*Përfaqësuar nga*

[•]



## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Blerësi/t**")

Nga ana tjetër:

3. **Ermond Parllaku**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 30.08.1982, lindur në Krume, Kukes dhe banues në adresën Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I20830060T (në vijim referuar si "**Shitësi**")

*Duke qenë se*

- A) Shitësi është pronar i një kuote që përfaqëson 0.5 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar („Kuota”) të shoqërisë ikubINFO SHPK regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T ("**Shoqëria**");
- B) Shitësi dhe Blerësit kanë nënshkruar midis tyre në datë 15.12.2021 Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotës („**Kontrata e Opsionit**") nëpërmjet të cilës Shitësi ka krijuar në favor të Blerësit një opsion ekskluziv për blerjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit dhe Blerësi ka krijuar në favor të Shitësit një opsion ekskluziv për shitjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit;
- C) Në Kontratën e Opsionit, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë nëpërmjet të cilës Shitësi në mënyrë përfundimtare pranon paraprakisht shitjen e Kuotës së tij në Shoqëri në Datën e Njoftimit e Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit të termit në Kontratën e Opsionit) si një formalitet ky që mund të lindë i nevojshëm për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi Kuotën nga Shitësi tek Blerësi pranë regjistrimit tregtar;

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:

### Neni 1

### **Përkufizime**

- 1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.
- 1.2 Të gjitha përcaktimet dhe përkufizimet e termave me gërma kapitale në Kontratën e Opsionit kanë të njëjtin kuptim në këtë Kontratë përveç rasis kur konteksti parashtron një kuptim të ndryshëm.

### **Neni 2**

#### **Objekti i Kontratës**

- 2.1 Objekt i kësaj Kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit tek Blerësi, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit në Kontratën e Opsionit), bashkë me të gjitha të drejtat e lidhura me këtë Kuotë.
- 2.2 Me kalimin e pronësisë së Kuotës në pronësi të Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes, Shitësi humbet çdo cilësi të ortakut në Shoqëri.

### **Neni 3**

#### **Çmimi i Kuotës dhe Mënyra e Pagesës**

- 3.1 Çmimi i Kuotës që përfaqëson tërësinë e pjesëmarrjes së Shitësit në Shoqëri është i barabartë me vlerën nominale të Kuotës në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes.
- 3.2 Blerësi do të paguajë çmimin brenda 30 ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes në llogarinë bankare të Shitësit të përcaktuar në Kontratën e Opsionit.

### **Neni 4**

#### **Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas nenit 2.
- 4.2 Shitësi është një person juridik i organizuar dhe që operon sipas ligjeve shqiptare.
- 4.3 Shitësi ka të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.4 Pronësia e Kuotës:
  - (a) Shitësi është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues i Kuotës;
  - (b) Kuota dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to (është e lirë nga cdo lloj pengu apo barre, e çfarëdo natyre qoftë, dhe Shitësi ka të drejta dhe fuqi të plotë për të shitur, kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën tek Blerësi, sipas dispozitave të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Opsionit.
- 4.5 Kuota përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar dhe paguar të Shoqërisë.
- 4.6 Shitësi nuk është në gjendje falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure likuidimi në çfarëdo juridiksioni dhe nuk ka propozuar asnjë Kontratë apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh.

### **Neni 5**

#### **Kostot**



- 5.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjërisht ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës.
- 5.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

#### Neni 6

#### Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 6.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.
- 6.2 Cdo mosmarrveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

#### Neni 7

#### Të Ndryshme

- 7.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të palëve.
- 7.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve.
- 7.3 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontrate dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontrates.
- 7.4 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe (njëra për Shitësin, një për Blerësin dhe një kopje për tu depozituar në regjistrin tregtar) secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.

#### BLERESIT

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k  
Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.  
Armand Shara  
Administrator i Përgjithshëm



#### SHITESI

Ermond Parlaku

*Ermond Parlaku*

*Ermond Parlaku*

*EP*



**KONTRATË OPSIONI PËR SHITJEN E KUOTËS**  
**(CALL AND PUT OPTION AGREEMENT)**

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Bleresi**" ose te dy se bashku referuar si "**Bleresit**")

Nga ana tjetër:

3. **Iralda Mitro**, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e datëlindjes 14.05.1987, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga "Mihal Ciko", P. 1, H.6, Apt. 7, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal I75514075P (në vijim referohet si "**Shitesit**")

Duke qenë se

- A) **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 59.71 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 2,507,914 (dy milion e pesëqind e shtate mije e nenteqind e katermbedhjetë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.3% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Znj. Iralda Mitro nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- B) **TAG Engineering sh.p.k.** është pronar i një kuote që përfaqëson 40.29 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar të shoqërisë ikubINFO sh.p.k. regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T dhe seli në Rruga Rruga "Abdyl Frasherit", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3-4, Tirane, Shqipëri ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 1,692,086 (një milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e dy mije e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë dhe ka vendosur që një pjesë të kësaj kuote e cila përfaqëson 0.2% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë t'ia shesë Znj. Iralda Mitro nëpërmjet Kontratës për Shitjen e Kuotës datë 15.12.2021 ("**Kontrata për Shitjen e Kuotës**").
- C) Si rrjedhojë e Kontratës për Shitjen e Kuotës date 15.12.2021, Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k. do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 58.51% të kapitalit të paguar e regjistruar të Shoqërisë dhe TAG Engineering sh.p.k. do të ruajë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 39.49% të kapitalit të

paguar e regjistruar të Shoqërisë ndërsa Irulda Mitro do të fitojë pronësinë mbi një kuotë që përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar e paguar të Shoqërisë ("**Kuota e Shitësit**");

**D)** Është kusht për hyrjen në fuqi të Kontratës për Shitjen e Kuotës që:

- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Shitësi ka rënë dakord dhe dëshiron që të krijohet në favor të Bleresve e drejta (opsioni) për blerjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Blerësit**"), opion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Bleresve që të blejnë, dhe ngarkon Shitësin me detyrimin përfundimtar që të shesë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes sipas Nenit 2.1 në këtë Kontratë;
- palët të nënshkruajnë këtë kontratë me anë të së cilës Blerësit kanë rënë dakord dhe dëshirojnë që të krijohet në favor të Shitësit e drejta (opsioni) për shitjen e Kuotës së Shitësit në Shoqëri në pajtim me parashikimet e kësaj Kontrate ("**Opsioni i Shitësit**"), opion ky i cili i jep të drejtën por jo detyrimin Shitësit që të shesë, dhe ngarkon Blerësit me detyrimin përfundimtar që të blejnë Kuotën e Shitësit me rastin e ushtrimit nga Shitësi të Opsionit të Shitësit sipas Nenit 2.2 në këtë Kontratë (Opsioni i Shitësit së bashku me Opsionin e Blerësit "**Opsionet**").

**E)** Palët shprehen se janë dakord për marrjen përsipër të së drejtës ose detyrimit, sipas rastit, për të shitur ose për të blerë Kuotën e Shitësit, sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate;

**F)** Palët dëshirojnë gjithashtu që të rregullojnë marrëdhënien e tyre të ortakërisë gjatë kohëzgjatjes së Opsioneve, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:

## **Neni 1**

### **Përkufizime**

**1.1** Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.

## **Neni 2**

### **Opsioni i Blerjes dhe Opsioni i Shitjes**

#### **2.1 Opsioni i Blerjes**

**2.1.1** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Bleresve, një opion (e drejtë) ekskluziv i blerjes dhe, detyrimi i shitjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të ("**Opsioni i Blerjes**"). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.

**2.1.2** Opsioni i Blerjes mund të ushtrohet nga Blerësit në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh ("**Afati i Opsionit**") nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Blerjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Bleresve, te cilët mund të vendosin, në gjykimin e tyre të plotë, ta ushtrojnë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojnë ose të paraqesin ndonjë shkak ose arsye. Blerësit mund ta



ushtrorjné Opsionin e Blerjes në një ose më shumë herë, mbi të gjithë Kuotën e Shitësit ose vetëm për një pjesë të saj, me kusht që ushtrimi i Opsionit të Blerjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.

- 2.1.3 Shitësi, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ka dhënë pëlqimin e tij të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për shitjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve dhe ka pranuar se, Shitësi nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi të cdo lloj forme mbi Kuotën e Shitësit me palë të treta përpara përfundimit të Afatit të Opsionit.
- 2.1.4 Opsioni i Blerjes, e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin A ("Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes"), nëpërmjet të cilit Blerësit njoftojnë Shitësin se po ushtrojnë Opsionin e Blerjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit. Pavarësisht sa më lart, Shitësi ka detyrimin të nënshkruajë cdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes nga ana e Blerësve në Datën e Njoftimit.

## 2.2 Opsioni i Shitjes

- 2.2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të Shitësit, një opsion (e drejtë) ekskluziv i shitjes dhe, detyrimi i blerjes së Kuotës së Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të ("Opsioni i Shitjes"). Për të shmangur çdo dyshim, Kuota e Shitësit përfshin çdo rritje apo zvogëlim të vlerës së saj për shkak të zvogëlimit apo rritjes së kapitalit të Shoqërisë.
- 2.2.2 Opsioni i Shitjes mund të ushtrohet nga Shitësi, në çdo moment, brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh ("Afati i Opsionit") nga Data e Kontratës. Ushtrimi i Opsionit të Shitjes mbetet tërësisht në vlerësim dhe dëshirë të Shitësit, i cili mund të vendosë, në gjykimin e tij të plotë, ta ushtrojë atë ose jo, pa patur nevojë të vërtetojë ose të paraqesë ndonjë shkak ose arsye. Shitësi mund ta ushtrojë Opsionin e Shitësit vetëm mbi të gjithë Kuotën e Shitësit me kusht që ushtrimi i Opsionit të Shitjes të ushtrohet brenda Afatit të Opsionit.
- 2.2.3 Blerësit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kanë dhënë pëlqimin e tyre të lirë, përfundimtar dhe të parevokueshëm për blerjen e Kuotës së Shitësit si pasojë e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit.
- 2.2.4 Opsioni i Shitjes e për pasojë, transferimi i pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit, prodhon efekte ligjore nga data e njoftimit në formë dhe përmbajtje sipas projektit bashkangjitur në Aneksin B ("Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes"), nëpërmjet të cilit Shitësi njofton Blerësit se po ushtron Opsionin e Shitjes. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën e Shitësit tek Blerësit ndodh në Datën e Njoftimit pa lindur nevoja që palët të kryejnë ndonjë formalitet të mëtejshëm në lidhje me transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit tek Blerësit.
- 2.2.5 Pavarësisht sa më lart, Blerësit kanë detyrimin të nënshkruajnë cdo dokument apo marrëveshje tjetër apo të ndërmarrë çdo veprim tjetër të nevojshëm me qëllim vërtetimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit pas ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga ana e Shitësit në Datën e Njoftimit.

## 2.3 Dispozita të përbashkëta për Opsionin e Shitjes dhe Opsionit të Blerjes



- 2.3.1 Pa cenuar qëllimin e pikës 2.1.4 dhe 2.2.4 dhe, vetëm për të kënaqur kërkesat që mund të lindin për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitesi tek Blerësit pranë regjistratit përkatës tregtar, palët kanë nënshkruar në Datën e Kontratës një kontratë përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e cila prodhon efekte juridike përkatësisht në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitësit ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerësit, cilido njoftim të jetë i pari. Të gjitha kopjet e kontratës të nënshkruar sipas kësaj pike do të ruhen nga Blerësit, të cilët kanë detyrimin t'i dorëzojnë Shitësit kopjen përkatëse të kontratës në rastet kur secila nga Palët ushtron të drejtën e Opsionit të Shitjes apo Blerjes përkatësisht brenda Afatit të Opsionit.
- 2.3.2 Palët bien dakord që pas përfundimit të Afatit të Opsionit të përcaktuar në pikën 2.1.2 dhe 2.2.2 të kësaj Kontrate dhe nëse e drejta e Opsionit të Blerjes ose Shitjes nuk është ushtruar nga Pala përkatëse, kontrata përfundimtare për shitjen e plotë të Kuotës së Shitësit e përmendur në pikën 2.3.1 do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme dhe Palët do t'i shkatërrojnë ato në prani të njëra-tjetrës.

### **Neni 3 Çmimi i Shitjes**

- 3.1 Në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes ose Opsionit të Shitjes përkatësisht nga Blerësit apo nga Shitësi, Blerësit do t'i paguajnë Shitësit për fitimin e pronësisë mbi Kuotën e Shitësit, çmimin total të barabartë me vlerën nominale të Kuotës së Shitësit në Datën e Njoftimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Shitjes ose, sipas rastit, Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes. Llogaria bankare e Shitësit në të cilën do të kryhet pagesa e çmimit.
- 3.2 Palët kanë pranuar shprehimisht se pronësia mbi Kuotën e Shitësit, kalon tek Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes ose në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes, sipas rastit, sipas pikave 2.1.4 ose 2.2.4 të kësaj Kontrate, pavarësisht momentit të pagimit të emimit nga ana e Blerësve.

### **Neni 4 Taksa, tatimet, shpenzimet**

- 4.1 Çdo taksë, tatim, shpenzim ose tarifa të tjera që duhen paguar si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i blerjes së Kuotës së Shitësit, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

### **Neni 5 Detyrime shtesë, Deklarata dhe Garanci**

- 5.1 Shitësi deklaron, merr përsipër dhe i garanton Blerësve sa më poshtë vijon:
- (a) Opsioni i Blerjes së Kuotës së Shitësit, sipas kësaj Kontrate është ekskluziv dhe Shitësi nuk do të krijojë në favor të personave të tretë opsione, kufizime apo të drejta të tjera në lidhje me Kuotën e Shitësit;
  - (b) Pëlqimi i Shitësit për shitjen e Kuotës së Shitësit me rastin e ushtrimit nga Blerësit të Opsionit të Blerjes është i lirë, përfundimtar dhe i parevokueshëm.
  - (c) Shitësi do të nënshkruajë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohet nga Blerësit me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsionit të Blerjes;
  - (d) Shitësi pranon se Blerësit do të udhëzojë Shoqërinë dhe administratorin e saj që të regjistrojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllimin e njohjes së palëve të treta me kufizimet



4



që rëndojnë mbi Kuotën e Shitësit për shkak të Opsionit të Blerjes dhe në përgjithësi të detyrimeve të tjera të Shitësit sipas kësaj Kontrate;

- (e) Gjatë Afatit të Opsionit, me përjashtim të parashikimeve në këtë Kontratë në favor të Blerësve, Shitësi do të ruajë Kuotën e Shitësit të lirë nga çdo barrë siguruese, peng, garanci pagese, barrë mbi interesat, opSION, ose të drejtë parablerje në favor të palëve të treta (secila më poshtë "**Barrë**");
- (f) Kuota e Shitësit që do të transferohet tek Blerësit sipas kësaj Kontrate, do të jetë e lirë nga çdo Barrë dhe e regjistruar rregullisht në emrin e Shitësit;
- (g) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit është ky Shitës apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin ky Shitës apo Shoqëria është palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Shitësi për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (h) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Shitësit.
- (i) Kontratat e shitjes që janë nënshkruar ose që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Blerjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk cënojnë në asnjë rast transferimin e pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes.

## 5.2 Blerësit deklarojnë, marrin përsipër dhe i garantojnë Shitësit sa më poshtë vijon:

- (a) Pëlqimi i Blerësve për blerjen e Kuotës së Shitësit në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes nga Shitësi është i lirë, përfundimtar dhe i përvokueshëm.
- (b) Blerësit do të nënshkruajnë kontratën/at e shitjes apo çdo akt tjetër të nevojshëm ose që mund t'i kërkohej nga Shitësi me qëllim realizimin e kalimit të pronësisë së Kuotës së Shitësit pas ushtrimit të Opsioneve;
- (c) Nënshkrimi dhe plotësimi nga Blerësit i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve të tjera të Blerësve, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë keto Blerës, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin Blerësit janë palë, që do të cënonte aftësinë e këtij Blerësve për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Kontratës nuk do (i) t'u japë të tretëve ndonjë të drejtë, përfshirë të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimit të zgjidhjes, në lidhje me çdo marrëveshje, kontratë apo detyrim të cituar në këtë paragraf ose (ii) të kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi të ndryshëm nga asambleja e Blerësve.
- (e) Kontratat e shitjes që duhen nënshkruar mes palëve në rastin e ushtrimit të Opsionit të Shitjes konsiderohen vetëm si një veprim formal shtesë, që mund të nevojitet për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësit dhe nuk cënojnë në asnjë rast transferimin e

5

pronësisë së Kuotës së Shitësit nga Shitësi tek Blerësit, i cili ndodh pa asnjë kusht ose formalitet tjetër shtesë, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Shitjes.

#### **Neni 6**

##### **Dëmshpërblimi**

- 6.1 Palët do të dëmshpërblejnë njëra-tjetrën dhe do ta mbajnë të pacenuar palën tjetër për çdo humbje, dëm, detyrim dhe shpenzim (përfshihet tarifën dhe shpenzimet ligjore) (së bashku "Dëmi") nëse Dëmi të tilla janë përballuar nga pala përkatëse dhe rrjedhin apo janë të lidhura me pasaktësi, mospërmbushje apo shkelje të detyrimeve, deklaratave dhe garancive të palës tjetër sipas kësaj Kontrate.

#### **Neni 7**

##### **Zgjidhja**

- 7.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me miratimin me shkrim të Palëve dhe në rastet e tjera të parashikuara në të.

#### **Neni 8**

##### **Të ndryshme**

- 8.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve, dhe në rast të kundërt gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
- 8.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtarëve të palëve. Të drejtat, privilegjet, apo detyrimet e përcaktuara, që kanë lindur apo janë krijuar nga kjo Kontratë, nuk mund të transferohen pa miratimin paraprak me shkrim të çdo Pale.
- 8.3 Palët bien dakord dhe duhet të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për regjistrimin e kësaj Kontrate në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim informimin e palëve të treta.
- 8.4 Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim të të dyja palëve.
- 8.5 Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera të kërkuara apo të lejuara, që duhet t'ju jepen palëve në Kontratë duhet të bëhen me shkrim si dhe të dërgohen me faks apo postohen me postë të regjistruar, apo të dorëzohen me Korrier, në adresën e palës, ashtu siç përcaktohet më poshtë, ose në çdo adresë tjetër të vlefshme që palët i kanë bërë të ditur njëra-tjetrës me shkrim në përputhje me këtë pikë 9.4. Dorëzimi i njoftimeve në emër të secilës palë në adresat e mëposhtme përbën njoftim të vlefshëm sipas kësaj Kontrate, pavarësisht faktit që kjo palë mund të ketë ndryshuar adresë, për aq sa ky ndryshim nuk i është njoftuar vlefshmërisht me shkrim palës tjetër.

- Për Shitësin njoftimi do të bëhet në adresën :

*Rruga "Mihal Ciko", P. 1, H.6, Apt. 7, Tirane*

- Për Blerësit njoftimi do të bëhet në adresën:

*Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k: Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri*

*TAG Engineering sh.p.k: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë*

Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë secila.

**BLERËSIT**

**SHITËSI**

**Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k**

**Iralda Mitro**

Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.

Armand Shara  
Administrator i Përgjithshëm



IRALDA MITRO

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Iralda Mitro".

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Armand Shara".



## ANEKSLA

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Blerjes

[Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Blerjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")

**Në vëmendje të:** [Shitësi]

[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Blerjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Shitësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Blerjes] në cilësinë e [Blerësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përcaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës ekskluzive në favor të Blerësit për të blerë të gjithë kuotën tuaj në kapitalin e shoqërisë ikubInfo SHPK, me vlerë totale nominale prej [ ] Lekesh.

Çmimi i blerjes është [ ] Lekë dhe do të paguhet sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

Përfaqësuar nga

[•]

## ANEKSI B

### Forma e Njoftimit të Ushtrimit të Opsionit të Shitjes [Letër me kokë e Mbajtësit të Opsionit të Shitjes]

**Data:** [Dita/Muaji/Viti] ("Data e Njoftimit")

**Në vëmendje të:** [Blerësi]

[Adresa]

**Objekti:** Ushtrimi i Opsionit të Shitjes sipas Kontratës së Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•]

Të nderuar,

Ky njoftim dërgohet bazuar në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotave datë [•] nënshkruar midis jush në cilësinë e [Blerësit] dhe [mbajtësi i Opsionit të Shitjes] në cilësinë e [Shitësit] ("Kontrata").

Të gjithë termat apo shprehjet me gërma kapitale në këtë njoftim, kanë kuptimin e përeaktuar në Kontratë.

Nëpërmjet këtij njoftimi ju njoftojmë ushtrimin e të drejtës së Shitësit për të shitur të gjithë kuotën në pronësi të Shitësit në kapitalin e shoqërisë ikubINFOSIIPK, me vlerë totale nominale prej [\_\_\_] Lekesh.

Cmimi i blerjes është [\_\_\_] Lekë dhe duhet paguuar sipas kushteve të rëna dakord në nenin 3 të Kontratës.

Me respekt,

[•]

Përfaqësuar nga

[•]

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 15.12.2021 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Investment SHERKO - ikub GROUP sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L21318042U, me seli në adresën: Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratorja e Përgjithshme, Znj. Migena Sherko;
2. **TAG Engineering Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar, regjistruar pranë regjistrit tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS - L72407008S, me seli në adresën: Godina Gjergji Center, Rruga Murat Toptani, Kati i 3-te, Zyra Nr.2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Armand Shara;

(në vijim referuar si "**Blerësi/t**")

Nga ana tjetër:

3. **Iralda Mitro**, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e datëlindjes 14.05.1987, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga "Mihal Ciko", P. 1, H.6, Apt. 7, Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. personal I75514075P (në vijim referuar si "**Shitësi**")

*Duke qenë se*

- A) Shitësi është pronar i një kuote që përfaqëson 0.5 % të kapitalit të regjistruar dhe paguar („Kuota“) të shoqërisë ikubINFO SHPK regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 12.05.2011, me NUIS L11712002T ("**Shoqëria**");
- B) Shitësi dhe Blerësit kanë nënshkruar midis tyre në datë 15.12.2021 Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotës („**Kontrata e Opsionit**“) nëpërmjet të cilës Shitësi ka krijuar në favor të Blerësit një opsion ekskluziv për blerjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit dhe Blerësi ka krijuar në favor të Shitësit një opsion ekskluziv për shitjen e Kuotës sipas kushteve dhe detyrimeve të Kontratës së Opsionit;
- C) Në Kontratën e Opsionit, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë nëpërmjet të cilës Shitësi në mënyrë përfundimtare pranon paraprakisht shitjen e Kuotës së tij në Shoqëri në Datën e Njoftimit e Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit të termit në Kontratën e Opsionit) si një formalitet ky që mund të lindë i nevojshëm për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi Kuotën nga Shitësi tek Blerësi pranë regjistrit tregtar;

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:



## **Neni 1** **Përkufizime**

- 1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme dhe anekset e Shtojcat (nëse do të ketë) janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate.
- 1.2 Të gjitha përcaktimet dhe përkufizimet e termave me gërma kapitale në Kontratën e Opsionit kanë të njëjtin kuptim në këtë Kontratë përveç rastit kur konteksti parashtron një kuptim të ndryshëm.

## **Neni 2** **Objekti i Kontratës**

- 2.1 Objekt i kësaj Kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit tek Blerësi, në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes (sipas përkufizimit në Kontratën e Opsionit), bashkë me të gjitha të drejtat e lidhura me këtë Kuotë.
- 2.2 Me kalimin e pronësisë së Kuotës në pronësi të Blerësit në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes, Shitësi humbet çdo cilësi të ortakut në Shoqëri.

## **Neni 3**

### **Çmimi i Kuotës dhe Mënyra e Pagesës**

- 3.1 Çmimi i Kuotës që përfaqëson tërësinë e pjesëmarrjes së Shitësit në Shoqëri është i barabartë me vlerën nominale të Kuotës në Datën e Njoftimit të Opsionit të Blerjes/Shitjes.
- 3.2 Blerësi do të paguajë çmimin brenda 30 ditëve kalendarike nga Data e Njoftimit të Opsionit të Blerjes në llogarinë bankare të Shitësit të përcaktuar në Kontratën e Opsionit.

## **Neni 4**

### **Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas nenit 2.
- 4.2 Shitësi është një person juridik i organizuar dhe që operon sipas ligjeve shqiptare.
- 4.3 Shitësi ka të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.4 Pronësia e Kuotës:
  - (a) Shitësi është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues i Kuotës;
  - (b) Kuota dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to (është e lirë nga çdo lloj pengu apo barre, e çfarëdo natyre qoftë, dhe Shitësi ka të drejta dhe fuqi të plotë për të shitur, kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën tek Blerësi, sipas dispozitave të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Opsionit.
- 4.5 Kuota përfaqëson 0.5% të kapitalit të regjistruar dhe paguar të Shoqërisë.
- 4.6 Shitësi nuk është në gjendje falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure likuidimi në çfarëdo juridiksioni dhe nuk ka propozuar asnjë Kontratë apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh.



## Neni 5

### Kostot

- 5.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjërisht ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës.
- 5.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

## Neni 6

### Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 6.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.
- 6.2 Cdo mosmarrveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

## Neni 7

### Të Ndryshme

- 7.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të palëve.
- 7.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtarëve të palëve.
- 7.3 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontrates.
- 7.4 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe (njëra për Shitësin, një për Blerësin dhe një kopje për tu depozituar në regjistrin tregtar) secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.

### BLERESIT

Investment SHERKO – ikub GROUP sh.p.k

Migena Sherko  
Administratore e Përgjithshme

TAG Engineering sh.p.k.  
Armand Shara  
Administrator i Përgjithshëm



### SHITESI

Iralda Mitro

IRALDA MITRO

